VENDIM
Nr.1015, datë 14.10.2009

PËR LEJIMIN E SHTYRJES SË AFATIT TË PROCEDURAVE TË PROKURIMIT, ME OBJEKT, PËRKATËSISHT, "LICENCIMI I PLOTË I SISTEMIT TË THESARIT" DHE "SHËRBIM KONSULENCE PËR SISTEMIN KOMPJUTERIK TË THESARIT", NË MINISTRINË E FINANCAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe të nenit 9 të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 "Për buxhetin e vitit 2009", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Ministrisë së Financave, që, brenda datës 30.12.2009, të kryejë procedurat e prokurimit, me objekt:

a) "Licencimi i plotë i sistemit të Thesarit";

b) "Konsulencë për sistemin kompjuterik të Thesarit, për transferimin e njohurive stafit funksional të Thesarit".

Brenda këtij afati përfshihet edhe lidhja e kontratës përkatëse.

2. Fondi limit për kryerjen e procedurave të prokurimit me objekt:

- "Licencimi i plotë i sistemit të Thesarit" është në vlerën 20 220 000 (njëzet milionë e dyqind e njëzet mijë) lekë dhe përballohet nga buxheti i vitit 2009.
- "Konsulencë për sistemin kompjuterik të Thesarit për transferimin e njohurive stafit funksional të Thesarit" është në vlerën 19 000 000 (nëntëmbëdhjetë milionë) lekë dhe do të përballohen nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

3. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha